

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHERBIMIN INFORMATIV SHTETËROR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **SHISH** me objekt: “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, për periudhën 1/1/2009 deri më 31/3/2012” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 99, datë 30/06/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 354/6, datë 30/06/2012 dërguar **Z. Bahri Shaqiri, Drejtor i SHISH**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i kryer për zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, u konstatua se nga Njësia Publike është miratuar në vitin 2011 rregullorja e brendshme për funksionimin e veprimtarisë së të gjitha strukturave të institucionit, si dhe rregulloret për funksionimin e strukturave të veçanta të tij, por në to nuk janë reflektuar kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe ndryshimet strukturore për vitin 2012.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Shërbimi Informativ i Shtetit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, në lidhje me përgjegjshmërinë menaxheriale, kompetencat dhe përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues, Nëpunësit zbatues dhe menaxherët e tjerë të njësisë, të marrë masa të reflektojë të gjitha ndryshimet e duhura në aktet e brendshme të funksionimit të institucionit, si dhe hartimin e miratimin e të gjitha rregulloreve të funksionimit të njësive të veçanta.

Menjëherë

2. Nga auditimi i kryer rezultoi se, nga Njësia Publike nuk janë ndërmarrë hapat e përcaktuar në nenin 21, të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut apo përcaktimi i procedurave për menaxhimin e riskut.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Shërbimi Informativ i Shtetit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë dhe regjistrin të riskut, si dhe përcaktimin e procedurave për identifikimin dhe menaxhimin e tij.

Menjëherë

3. Nga auditimi i kryer për saktësinë e pasqyrave financiare për vitin 2009, 2010 dhe 2011 rezultoi se, në magazinat e institucionit ndodhen mallra stok dhe me qarkullim të ngadalshëm të krijuara që nga viti 1991, dhe konkretisht: 932 artikuj, në vlerën 170,816,079 lekë, të cilat gradualisht po humbin vlerën e përdorimit si rezultat i amortizimit, apo i futjes së teknologjisë së re.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Shërbimi Informativ i Shtetit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të marrë masa për nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre mallrave stok të cilët kanë humbur cilësinë dhe vlerën e përdorimit dhe që ndodhen gjendje në fund të vitit 2011. Për materialet që vlerësohen si materiale mbeturinë, skarco, rikupero, etj., të jepen për përdorim të mëtejshëm në destinacionet që cakton vetë institucioni.

Deri më 31/12/2012

4. Nga auditimi i kryer për saktësinë e pasqyrave financiare për vitin 2009, 2010 dhe 2011 rezultoi se, teprica e llogarisë 423 “Persona, defiçite e gjoba” në datën 1/1/2009 është në vlerën 5,991,656 lekë për 109 persona, të krijuar para vitit 2005, por që akoma nuk janë arkëtuar.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Shërbimi Informativ i Shtetit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të marrë masa për arkëtimin dhe sistemimin e debitorëve të krijuar dhe trashëguar para vitit 2005.

Vazhdimisht

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Selime Bicaj Përgjegjës Grupi, Rasim Hoxha dhe Vladimir Vangjeli. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Koço Sokoli (në mungesë të Drejtorit të Drejtorisë dhe me porosi), si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLI I LARTË I SHTESTIT